



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 3 dhe 18, dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 pika 4, neni 24 dhe 41 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

POLITIKA PËR NDRYSHIMIN E POLITIKËS PËR MENAXHIMIN DHE INVESTIMIN E REZERVAVE VALUTORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. Në Politikën për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15) në pikën 4 paragrafi 4, alinea 3 ndryshohet dhe thotë:

"Portofoli i investimeve, i cili mund të ketë periudhë investimi më shumë se një vit dhe që menaxhohet për shkak të rritjes së kthimit të rezervave valutore, si dhe për mbulimin e detyrimeve të paparashikuara në afat më të gjatë për shkak të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit. Ky portofol investohet në instrumente financiare me rrezik më të lartë për shkak të realizimit të kthimit më të lartë nga investimet, megjithatë në pajtim me tolerancën e rrezikut të përcaktuar me këtë politikë. Në kuadër të portofolit të investimeve, një pjesë e caktuar e letrave me vlerë mund të klasifikohen si letra me vlerë të ruajtura deri në maturim, më së shumti deri në 750 milionë euro në kundërvlerë, me afat maturimi maksimal deri në 10 vjet."

2. Në pikën 14 paragrafi 1, fjalët "gjegjësisht kthimi pozitiv gjatë një periudhe investimi prej dy vitesh" fshihen.

3. Kjo politikë hyn në fuqi me ditën e miratimit dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

P nr.02-15/VIII-1/2016
28 korrik 2016
Shkup

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богров